

## NË EMËR TË POPULLIT

**Gjykata Themelore në Prizren** - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Artan Sejrani, me bashkëpunëtorin profesional Atnor Skoro, në çështjen penale kundër të akuzuarit B. Sh. nga Prizreni, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i besimit nga neni 342 paragrafi 1 të KP të Kosovës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, PP.nr.1192/12 të datës 14.06.2013, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik në prezencën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, Prokuror Sahide Sefa, në mungesë të akuzuarit, të dëmtuarit H. B. dhe përfaqësuesit të tij av. F. Sh. nga Prishtina, me datë 04.06.2015, publikisht mori dhe shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

#### **I akuzuari:**

**B. SH.**, nga i ati R., e ëma R., të vajzërisë Y., data e lindjes ... në Prizren, ku edhe tani jeton, i martuar, baba i katër fëmijëve, punëtor, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqipëtar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Në bazë të nenit 364 par. 1 nën par. 1.3 të KPPK

### **LIROHET NGA AKUZA**

Se gjatë muajit shtator të vitit 2009, në Prizren, gjatë përfaqësimit të interesave punësore të dëmtuarit H. B., dhe biznesit të tij "NTN E. L.", nuk i përmbush detyrimet e tij me qëllim që vetit ose personit tjetër t'i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme apo ta dëmtojë personin, interesat pasurore të të cilit ai i përfaqëson, në atë mënyrë që nuk i përmbush detyrimet të cilat janë dhënë në bazë të autorizimit nga ana e të dëmtuarit si përfaqësues i "NTN E. L.", duke mos bërë zhdoganimin e mallit i cili ka arritur në zyrën doganore në Vërmicë me datën 19.09.2009, përkundër asaj që në bazë të autorizimit ka qenë i detyruar që të veprojë, me ç'rast të dëmtuarit i shkakton, dëm të konsiderueshëm material.

**Kësodore kishte për të kryer veprën penale keqpërdorimi i besimit nga neni 342 par. 1 të KP-së.**

Pasi që nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

I dëmtuari H. B. nga fshati M. e E., Komuna e Fushë Kosovës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren, ka parashtruar Aktakuzën PP.nr.1192/2012 të datës 14.06.2013, kundër të akuzuarit B. Sh. nga Prizreni, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i besimit nga neni 342 paragrafi 1 të KP të Kosovës.

Aktakuzën në shqyrtim gjyqësor e ka përfaqësuar Prokurori i Shtetit – i Prokurorisë Themelore në Prizren, Sahide Sefa dhe në fjalën përfundimtare ka theksuar se mbetet në tërësi pranë aktakuzës PP.nr.1192/2012 të datës 14.06.2013, të ushtruar ndaj të akuzuarit B. Sh. nga Prizreni, për shkak të veprës penale të keqpërdorimit të besimit nga neni 342 paragrafi 1 të KP të Kosovës, ku në bazë të provave të cilat janë administruar e të cilat janë parashtruar me aktakuzë, është vërtetuar që i akuzuari ka pasur autorizim nga pala e dëmtuar për zhdoganimin e mallit dhe në bazë të autorizimit i njëjti nuk ka vepruar gjë që për të cilën ka pasur për detyrë që të veprojë në bazë të këtij autorizimi, andaj në veprimet e të akuzuarit formohen elementet e veprës penale e cila i vihen në barrë dhe i propozon gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe dënojë sipas ligjit.

Përfaqësuesi i të dëmtuarit H. B. avokat F. Sh. në fjalën përfundimtare ka theksuar se i bashkëngjitet ndjekjes penale të prokurorisë së shtetit dhe se në veprimet e të akuzuarit manifestohen lëshime të cilat mund të konsiderohen se është keqpërdorur besimi që ka marrë pronari i firmës “ E. L.” në rastin e doganimit të mallit të firmës së lartpërmendur, i akuzuari i ka ditur këto probleme që janë shfaqur gjatë doganimit të këtij malli dhe procedurës kundërvajtëse doganore si dhe interesimet e palës përkatësisht firmës transportuese lidhur me fatin e kamionit me mall doganor të cilët e kanë transportuar kjo firmë “ P. “ dhe gjatë tërë kohës ka lejuar kyçjen e tyre në marrjen e këtij kamioni nga dogana. Po ashtu pala e dëmtuar edhe me një shkresë me datë 16.05.2015 i është drejtuar prokurorit të shtetit se ka vërejtur se në procedurën e doganimit të firmës “ E. L. “ ka indikacione se ka lëshime edhe nga zyrtarët përgjegjës të Doganës së Kosovës – dega në Vërmicë të cilët kanë lejuar që në kundërshtim me ligjin të lejojnë daljen e këtij kamioni nga terminali doganor me ç ‘rast të dëmtuarit i është shkaktuar dëm pasuror në vlerë prej 48.000.00 euro, pasi që ky ka qenë çmimi të cilën i dëmtuari do të fitonte pas zhdoganimit të mallit dhe blerësi i mallit ishte M. G. nga Suhareka. Po ashtu vërehen lëshime tek i akuzuari edhe në faktin se pasi me datë 18.11.2009 kuptonë nga i

dëmtuari se ai nuk ka kurrfarë roli në “ nxjerrjen e kamionit nga dogana “, nuk ndërmori asnjë veprim në kuptim të hulumtimit të rastit tek organet kompetente ( policia dhe dogana ), pasi që kishte pas mundësi të vërtetojë saktësisht se në çfarë mënyre kamioni doli nga terminali doganor dhe kush e bëri këtë lëshim e aq më tepër kur ky është në dijeni se përfaqësuesja e ndërmarrjes transportuese D. F. tërë kohën bashkë me pronarët e firmës “P.” ishin të interesuar për mënyrën se si të bëhet pagesa e doganës përkatësisht si ta qesin kamionin nga terminali doganor. Po ashtu paraqet edhe kërkesë pasurore juridike në shumën prej 48.000.00 euro.

I akuzuari B. Sh. duke mohuar kryerjen e veprës penale në mbrojtjen e vet ka theksuar se gjatë vitit 2009 ka punuar si agjent doganor që ka të bëjë me përgatitjen e dokumentacionit për zhdoganim të mallit, ku i marrin autorizimet nga pronarët e firmës. Të dëmtuarin H. B. e njeh, i cili i ka dhënë autorizim me shkrim për ta përfaqësuar dhe zhdoganuar mallin. I akuzuari mes tjerash ka deklaruar se procedura që bëhet për zhdoganim të mallit i cili ka shtuar se sipas dokumentacionit që vjen nga vendi i nisjes, në atë dokument ekziston fatura, deklaratën eksportuese prej cilit vend është nis malli dhe CMR e cila është dokument ndërkombëtarë për peshën e mallit, në moment kur hynë kamioni e lajmëron pronari që ka ardhur malli dhe detyra e tij është që të shkon në hyrje të doganës ku doganierët e regjistrojnë mallin, pasi që e regjistrojnë i merr të gjithë dokumentacionin dhe në zyrën e tij i plotëson deklaratat unike doganore të quajtura DUDAT, sipas faturave dhe peshave që i kanë, jashtë këtyre kornizave nuk guxon të dal të cilat janë shënuar dhe përcaktuar në dokumentacionin që ka ardhur. Po ashtu çdo palë që vjen në zyrën e tij obligim primar i tij është që të tregojë a ka ndonjë mall të pa deklaruar (jashtë faturave) të cilën e plotëson me një deklaratë të cilës i bashkëngjet dhe pastaj e dorëzon në doganë. Në rastin konkret ka theksuar se i ka deklaruar në dogan siç ka qenë në fatura, pastaj dogana e kontrollon dokumentacionin se a është në rregull mos ka ndonjë gabim nga ana e tij, dogana nuk ka gjetur ndonjë gabim pasi që çdo gjë ka qenë në rregull, pastaj dogana ka dalë në shiqim të mallit, malli ka qenë i deklaruar si mall me defkte, gjatë kontrollës zyrtarët doganorë kanë hasur në gjeneratorë të ri, në kilovat prej 1.5 të deklaruar në faturë ndërsa gjendja faktike e gjeneratorëve ka qenë 4.5 KV, kanë gjetur edhe aspirator e për sene tjera nuk i kujtohet, pastaj dogana të dëmtuarit përkatësisht firmës “E. L.” i kanë shqiptuar një kundërvajtje me dënim me gjobë. Gjatë gjithë kësaj kohe ka qenë prezent edhe i dëmtuari dhe se ka qenë i informuar për gjobën dhe parregullsitë, së bashku me të kemi shkuar në Prishtinë dhe i njëjti ka kërkuar që të bëhet A – testi i gjeneratorëve e cila është bërë në një firmë private ku dogana nuk e ka pranuar atë raport dhe më pastaj ka ardhur një kombi nga Prishtina i doganës ku kanë marrë gjeneratorin të cilin e kanë testuar ku i cili nuk ka dal me defekt siqë është deklaruar, pastaj i dëmtuari përse nuk e ka paguar gjobën dhe doganën nuk e din, kamioni ka qëndruar në terminal doganor 3 muaj dhe një ditë duke zbritur nga hotel Theranda e cila

gjendet në qendër të Prizrenit afër urës së gurit e ka parë kamionin e të dëmtuarit i cili ka shkuar në drejtim të Prishtinës, e ka thirr me telefon të dëmtuarin dhe i ka thënë “ shyqyr e paske zhdoganuar mallin, i cili iu përgjigj se nuk e ka zhdoganuar mallin dhe më pastaj i akuzuari i ka thënë se kamioni shkoj në drejtim të Prishtinës “. Autorizimin të cilin ma ka dhënë i dëmtuari e kam zbatuar në përpikmëri dhe procedura ka ngelur te pagesa pasi të gjithë dokumentacionin e kam përfunduar veq është dashur i dëmtuari të vijë dhe të bëjë pagesën, me përgjegjsi të plot deklaroj se ditën kur ka dal kamioni nuk kam qenë prezentë në Doganë – Vërmicë dhe kam bindjen se kamionin e ka lëshuar D. Gj., e cila e ka vërtetuar edhe me deklaratën e vet të dhënë në gjykatë. Dogana mundet me lëshuar mallin, pasi që unë si shpediter nuk nënshkruaj askund, ndërsa me ligj nuk mundet me leshu pa dijenin time. I akuzuari mes tjerash ka shtuar pasi që të kryhet shikimi i mallit dalin fletë pagesat të cilat paguhen në bankë ka raste kur vetë pronari i paguan ndërsa në flet pagesë të bankës duhet të nënshkruhet dikush, nënshkrim i vetëm i shpeditërit (të akuzuarit) i nevojitet vetëm në deklaratën unike e cila dorëzohet në fillim të zhdoganimit të mallit. Nuk kam pas njohuri që D. ka pas autorizim për zhdoganim të mallit, por ka theksuar se ka mund të nxjerrë kamionin me ndihmën e D. Gj. e cila ka qenë kompetente për të lëshuar kamionin nga terminali doganor. Po ashtu ka shtuar se faturat e mallit të dorëzuar kanë qenë në gjuhën gjermane përkthimin e së cilës e ka bërë i dëmtuari. Po ashtu se në urdhër pagesën e datës 18.11.2009 shihet se këto i ka përgaditur D. Gj. Po ashtu gjatë periudhës tre mujore e ka thirr në telefon të dëmtuarin i cili nuk e ka hapur telefonin e tij dhe më pastaj e ka thirr N. i cili ka qenë prezent me të dëmtuarin kur e kanë angazhuar si shpediter dhe të cilin e ka burr të motrës, i cili e ka njoftuar se Isniu nuk ka të holla që të paguan doganën për këtë arsye kamioni ka mbetur në terminal.

Gjatë procedurës është dëgjuar i dëmtuari H. B. i cili në mes tjerash ka theksuar se kur ka ardhur prej Gjermanisë me kamion në pikën kufitare në Vërmicë ka kërkuar shpediter për zhdoganimin e mallit dhe B. Sh. ka qenë i lirë të cilin e ka autorizuar për zhdoganim të mallit. Më pastaj e ka autorizuar me shkrim të akuzuarin i cili autorizim është bërë në zyrën e tij të quajtur “ B. Sh. “ në pikën kufitare në Vërmicë. Autorizimi në përmbajtjen e tij ka pasur për qëllim zhdoganimin e mallit përkatësisht teknik të bardhë si janë: frigorifer, shporet, makinë të enëve etj, dhe i akuzuari i kërkuar shumën prej 500 euro kinse do ti jep shefit të doganës dhe shefit të ndërrimit si dhe ka kërkuar shpërbimin për shpediter shumën prej 120 euro të cilën ia ka dhënë. Koha që është dashur të kryhet doganimi i mallit ka qenë tri ditë, mirëpo pas kalimit afat prej tri ditësh nuk është kryer zhdoganimi i mallit, ndërsa doganimi është bërë në ditën e katërt ku kamionin e ka vendosur në terminal në të cilën është kontrolluar dhe më pas e kanë nënshkruar dënimin me gjobë në shumë prej 5000 euro. Në kamion ka qenë B. Sh., shefi i doganës dhe ai i ndërrimit dhe punëtorët e doganës, ku i akuzuari i ka treguar

se e kanë dënuar në shumën prej 5000 euro, për arsye se gjeneratori ka qenë i ri dhe se auspuhi nuk ka tymë, ndërsa arsyen e saktë e ka kuptuar pasi e ka marrë vendimin i cili në përmbajtje ka shkruar se gjeneratorët teknikisht kanë qenë në rregull, mirëpo nuk kanë dhënë rrymë. Malli i cili ka qenë në doganë ka qenë i shitur për të cilën ka marrë edhe kapar dhe malli është i blerë në Gjermani me defekte. Transportimin e mallit e ka bërë me transportues të Maqedonisë të cilën e ka gjetur D. F. e cila është nga Kavadraci i Maqedonisë ndërsa firma që ka bërë transportimin e mallit ka qenë firma " N. " pronë e N. Gjobën që e ka shqiptuar dogana nuk e kam paguar pasi që ndaj ati vendimi kam pas drejtë ankese dhe as doganën nuke kam paguar. D. F. ia kam dhënë 4500 euro dhe kinse ajo e ka paguar gjobën dhe doganën. Mes tjerash ka shtuar se gjatë qëndrimit 33 ditor të kamionit në terminal doganor ka qenë herë në Kosovë herë në Gjermani dhe kamionin nga dogana ka mund të nxjerrë vetëm B. Sh. ndërsa ndaj D. F. ka pas obligim në shumën prej 2500 euro për transport dhe ndërmjetësuese, të cilat para ka pas për t'ia dhënë kur malli të arrijë në Kosovë (në vend). Kamionin nga terminali e ka marrë firma N. me pronar N.

Dëshmitari Xh. P. ka dëshmuar se në pikën doganore ka punuar në vitin 2009 dhe ka qenë udhëheqës i pikës doganore në Vërmicë. Procedura në doganë për marrjen e mallit është se lënda dorëzohet nga agjendi doganor i autorizuar nga vetë subjekti, pastaj dogana i ka procedurat e veta të analizimit të lëndës dhe në rastin konkret kjo lëndë ka shkuar në kundërvajtje doganore. Kur pala i kryen të gjitha obligimet doganore malli lirohet në qarkullim të lirë dhe në rastin konkret subjekti " eurolindi " i ka kryer të gjitha obligimet doganore së bashku me doganën dhe malli është liruar në qarkullim të lirë. Në doganë kur vjen malli janë katër faza të procedurës doganore si deklarimi i mallit nga agjenti doganor, pranimi i deklaratës nga oficeri doganor, ekzaminimi i mallit dhe faza e fundit është lirim në qarkullim të lirë të mallit nga administrata pas kryerjes së pagesës. Me pranimin e pagesës dogana e konsideron se procedura ka përfunduar ndërsa sa i përket se përveç personit të autorizuar a mundet dikush tjetër të vjen të nxjerrë kamionin nga terminali doganor në kushte normale nuk vjen askush me bë pagesën e dikujt tjetër dhe në praktik nuk e din a ka pasur rast të till. Në pyetjen e gjyqtarit sa ka qenë vlera e mallit e cila është doganuar i njëjti ka theksuar në total ka qenë 12.000.00 euro. Në mes tjerash ka shtuar se kamioni ka qëndruar 60 ditë në terminal doganor pasi e ka bërë analizimin e lëndës i cili kamion ka qëndruar për shkak të një shkelje doganore dhe mos pagesës nga ana e palës. Në pyetjen e gjyqtarit se në flet pagesat e doganës ekziston emri i D. F. në rastin konkret e njëjta a ka pasur mundësi të tërheq kamionin pasi që është bërë pagesa nga ajo, i njëjti ka theksuar se ligjërisht nuk është dashur të tërhiqet.

Dëshmitari R. Xh. ka dëshmuar se gjatë vitit 2009 ka punuar në kullë në Pejë, ndërsa nga nëntori i të njëjtit të vitit të njëjti ka punuar në pikën doganore në

Vërmicë si shef i ndërrimit. Detyrat e tij kanë qenë për të menaxhuar ndërrimin e pikës kalimtare si dhe ndërrimin e terminalit doganor ndërsa sa i përket zhdoganimit të mallit ajo i ka disa faza. Në rastin konkret të akuzuarin e njeh si agjent doganor ndërsa të dëmtuarin nuk e njeh. Mes tjerash ka theksuar se pas zhdoganimit të mallit për largimin e mallit nga terminali doganor sipas praktikës është agjenti doganor dhe pala vetë. Ndërsa sa i përket rastit konkret i njëjti ka theksuar se nuk din asgjë dhe nuk i kujtohet pasi që kanë kaluar 5 vite nga ajo kohë.

Dëshmitari Sh. K. ka dëshmuar se mbetet në tërësi pranë deklaratës të dhënë në Stacionin Policor, ka theksuar se të dëmtuarit H. ia ka dhënë shumën prej 5000 euro, lidhur me mallin që e ka pasur në dogan. Me të akuzuarin janë takuar rreth vitit 2009 para një restoranti në Prizren, së bashku me H. dhe N., ku B. dhe H. kanë qenë të skajuar dhe bisedonin diçka të cilën bisedë nuk e ka dëgjuar dhe më pastaj H. i ka kërkuar shumën prej 500 euro, në fillim ka hezituuar me ia dhënë por pastaj ia ka dhënë duke i thënë i dëmtuari se ka punë me shpediterin rreth shpedicionit. Ndërsa me të dëmtuarin në Fushë Kosovë është takuar së pari me N., D. dhe djalin e saj të cilët e kanë thirrur vetë dhe e pritshin H. që atyre tui sjellë të hollat lidhur me doganimin e mallit dhe si ka ardhur H. menjëherë është larguar nga vendi ku ka qenë, pasi që nuk ka pasur asnjë interes për të qëndruar. Lidhur me të hollat ai ka sjellë H. dhe ai ka dhënë ato të holla N. dhe D., dëshmitari nuk e ka parë.

Dëshmitari N. M. ka dëshmuar se të dëmtuarin e njeh sepse i njëjti është burri i motrës. Gjatë vitit 2009 deri sa ka qenë në Gjermani, H. ka ngarkuar mall me kamion në të cilën edhe vetë ka futur tri biçikleta për fëmijët e tij, ndërsa vetë ka ardhur në Kosovë me ajroplan, ndërsa pas disa dite H. e ka lajmëruar se kamioni është nisur për në Kosovë, ndërsa H. ka ardhur me ajroplan të cilin e ka pritur në aeroportin e Sllatinës ku e ka marrë H. dhe Sh. K. dhe kanë ardhur në Prizren për tu takuar me B. Sh. me të cilën edhe janë takuar, ku të njëjtit i kanë treguar për mallin që ishte duke ardhur nga Gjermania dhe H. të akuzuarit i ka dhënë diçka por për çfarë qëllimi nuk e din, ndërsa pas një jave pasi e ka dërguar H. në Vërmicë dhe janë takuar me B., gjatë rrugës prej Prishtinës për në Prizren H. i ka thënë se po shkojmë në Prizren se puna është kryer dhe ka me dhënë një televizor dhe një gjenerator një doganieri dhe të njëjtit sa i kujtohet H. ia ka dhënë edhe shumën prej 500 euro. Ndërsa malli pse nuk ka mundur të doganohet ka qenë se H. nuk ka pasur të holla me vete dhe i ka treguar se mallin e ka shitur në Kosovë dhe është duke pritur të merr të hollat nga blerësi për të paguar më pastaj edhe doganën. Dëshmitari në mes tjerash ka theksuar se D. e njeh shumë mirë e cila ka qenë drejtoresh e kompanisë transportuese dhe e njëjta ka qenë përgjegjëse për transportin e mallit të H. nga Gjermania për në Kosovë. Me D. janë takuar pas 33 ditëve pasi që kamioni ka qenë në terminal dhe me të njëjtën janë takuar në Fushë Kosovë në picerin "E." e cila ka tmeruar njërezit me zërin e saj serbo-kroate dhe e ka kërcënuar H. që tia paguaj

shumën prej 10.000 si dënim pasi që ka mbetur kamioni në doganë. Të hollat e kërkuara H. nuk i ka paguar.

Dëshmitarja D. Gj. – P. ka dëshmuar se gjatë vitit 2009 në pikën doganore në Vërmicë ka punuar në administratë dhe puna e saj ka qenë pranimi i pagesave për lëndët e procesuara por ka bërë edhe punë tjera. Pas pagesës së bërë dhe futjes në sistem të pagesës i cili sistem e përpilon flet daljen dhe detyra e saj ka qenë që kopjen e lëndës tia kthen agjendit doganor. Fletdalja i dorëzohet së bashku me të gjitha dokumentacionet iu kthehet subjekteve dhe në rastin konkret ka lëshuar fletpagesë me datën 18.11.2009 rreth orës 15:19 e 39 sekonda, ndërsa fletpagesa ka qenë e bërë me të njëjtën datë në ora 15:14 minuta, po të njëjtën datë është bërë edhe një fletpagesë tjetër e cila pagesë është bërë 15:12 minuta. E njëjta mes tjerash ka theksuar se nuk e njeh D. F., ndërsa firmën e NTN “ E. L.” e ka dëgjuar por nuk i kujtohet që kamioni që ka bartur mall në emër të kësaj firme që ka qëndruar në terminal doganor rreth 2 muaj, pasi që ka kaluar një kohë e gjatë.

Gjykata në shqyrtim gjyqësor ka administruar një sërë provash dhe atë: procesverbalin në procedurën e rregullt për kundërvajtje prej 6 faqeve, është bërë leximi i DUD-ave me numra 17749,13409, 13410,13411 së bashku me dokumentet përcjellëse të datës 18.09.2009, lista e distribuimit me nr. ref.LJ – IX – 003 – 5247 – 04215 të datës 04.02.2015.

Gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka administruar të gjitha provat (provat e lartë theksuara) dhe pas analizimit të secilës provë veç e veç dhe të ndërlidhura si tërësi, ku të gjitha së bashku kanë vërtetuar se i akuzuari B. Sh. nuk e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, respektivisht veprën penale të keqpërdorimit të besimit nga neni 342 paragrafi 1 të KP të Kosovës.

Nga provat e theksuara më lartë - decidivisht nga: leximi dhe shikimi në DUD-a me numra 17749,13409, 13410,13411 së bashku me dokumentet përcjellëse të datës 18.09.200 – është vërtetuar se i akuzuari B. Sh. në mënyrë të përpikt e ka përmbushur detyrimin e vet sipas autorizimit karshi të dëmtuarit dhe gjithë dokumentacionin ia ka prezentuar doganës dhe procedura ka ngelur pasi që i dëmtuari nuk e ka bërë pagesën e gjobës dhe të doganës, poashtu është vërtetuar nga xhiro-fletdeponimi i lëshuar nga N. P. me seli në Prizren, në emër të klientit N.T.N. E. L. DUD 17749, 13411, 13410, 13409 të datës 18.11.2009, në emër të 00101 – Unmik Customs – D. F. me ID .... pagoi shumat prej 5.5000 euro, 2.906,04 euro, 1.503,33 euro, 107.92 eur dhe 33.12 euro, nga këto pagesa nuk ka mëdyshje se dënimin - gjobën për kundërvajtje të shqiptuar nga Dogana e Kosovës për të dëmtuarin H. B. dhe doganën dhe taksat administrative i ka paguar D. F. dhe pas

këtyre pagesave edhe kamioni me mall pas 33 ditësh është liruar për qarkullim të lirë nga terminali doganor pa dijenin e shpeditërit – të akuzuarit.

Po ashtu dogana e Kosovës nuk ka mundur të i siguroj inçizimet e pikës kufitare në Vërmicë dhe fletë daljen e kamionit të datës 18.11.2009 të kërkuara nga gjykata. Me shkresën e doganës së Kosovës me nr. Ref. LJ-IX-003-5247-040215 të datës 04.02.2015, gjykata është informuar “se periudha kohore prej gjashtë muajsh konsiderohet e mjaftueshme dhe arsyeshme për të mbajtur inçizimet nga ekstraktet e nxjerra të vëzhgimit me kamerë. Pas skadimit të kësaj periudhe kohore të paracaktuar, pamjet duhet të fshihen automatikisht. Prandaj nuk i posedojmë inçizimet për datën 18.11.2009”. Në “kamionin me targa xxx/xxx kanë qenë të ngarkuara mallra të cilat janë zhdoganuar përmes DUD-ve dhe në asnjërën prej DUD-ve nuk është bashkangjitur fletëdalja e kamionit me targa xxx/xxx”. Në mungesë të këtyre provave kjo gjykat nuk ka mundur të vërtetojë se i akuzuari ditën kritike a ka qenë në pikën kufitare në Vërmicë.

Gjendja e tillë faktike u vërtetua duke u mbështetur në mbrojtjen e të akuzuarit nga deponimi i deklaratve të dëshmitarëve dhe pjesërisht nga deklaratat e të dëmtuarit H. B., si dhe nga provat materiale të cekura si më lartë.

Prandaj gjykata në mbështetje në nenit 364, paragrafi 1 pika 1.3 të Kodit të Procedurës Penale, mori aktgjykim lirues me që nga provat e shqyrtuara në shqyrtim gjyqësor si dhe nga vetë kundërtëhëniet e dispozitivit të aktakuzës nuk rrjedh në mënyrë të padyshimtë se i akuzuari të mos i përmbush autorizimet të cilat janë dhënë në bazë të autorizimit me shkrim nga ana e të dëmtuarit, duke mos bërë zhdoganimin e mallit i cili ka arritur në pikën doganore në Vërmicë me datën 19.09.2009, përkundër autorizimit ka qenë i detyruar që të veprojë dhe me këtë rast ti shkakton dëm të konsiderueshëm material të dëmtuarit. Kjo vërtetohet nga vetë mbrojtja e të akuzuarit por edhe nga prova materiale përkatësisht nga leximi dhe shikimi në DUD me numra 17749,13409, 13410,13411 së bashku me dokumentet përcjellëse të datës 18.09.200 – përkatësisht nga xhiro-fletdeponimi i lëshuar nga N. P. me seli në Prizren, në emër të klientit N.T.N. E. L. DUD 17749, 13411, 13410, 13409 të datës 18.11.2009, në emër të 00101 – Unmik Customs – D. F. me ID ... pagoi shumat prej 5.5000 euro, 2.906,04 euro, 1.503,33 euro, 107.92 euor dhe 33.12 euro, nuk ka mëdyshje se dënimin për kundërvajtje të shqiptuar nga Dogana e Kosovës për të dëmtuarin H. B., doganën dhe të gjitha taksat administrative i ka paguar D. F. dhe pas pagesës së cilës edhe kamioni pas 33 ditësh është liruar për qarkullim të lirë nga terminali doganor pa dijenin e të akuzuarit.

Gjykata pretendimeve mbrojtëse të të akuzuarit dhe deklarimeve të tija të bëra gjatë shqyrtimit gjyqësor ia fali besimin në tërësi, pasi që mbrojtja e të



akuzuarit është në përputhje me të gjitha provat materiale siq janë DUD-at me të cilat është kryer puna e shpeditërit në përpikmëri dhe procedura ka ngelur vetëm te pagesa, të cilën është dashur ta kryen i dëmtuari apo të ia sjell të hollat shpeditërit për ta bërë pagesën.

Duke analizuar deklaratat e dëshmitarëve, gjykata vetëm sa e forcoi bindjen e saj se në rastin konkret i akuzuari B. Sh. nuk është përgjegjëse për veprën penale për të cilën akuzohet. Dëshmitarët e lartpërmedur asnjëri prej tyre nuk tregon se i akuzuari si shpeditëri privat në pikën doganore në Vërmicë duke mos i përmbush detyrat e tija të dhëna me autorizim nga i dëmtuari me qëllim që vetes apo personit tjetër ti sjell dobi pasurore të kundërligjshme duke mos bërë zhdoganimin e mallit dhe me këtë rast ti shkakton dëm material të dëmtuarit. Kjo sepse të gjithë dëshmitarët në mënyrë identike kanë treguar vetëm procedurën e arritjes së mallit në doganë deri në përfundimit të zhdoganimit të mallit. Asnjëri prej tyre nuk cek se i akuzuari të ketë qenë në dijeni për daljen e kamionit nga terminali doganor.

Pra nga dëshmia e dëshmitarëve dhe provat materiale të theksuara më lartë (të cilat gjenden në shkresat e lëndës), vihet deri tek konkludimi se i akuzuari në fjalë në mënyrë të pakontestueshme i ka përmbushur të gjitha detyrimet e tija të dhëna në bazë të autorizimit. Ndërsa kontestuese ka qenë fakti si ka dalë kamioni nga terminali doganor pas 33 ditësh kur dihet se për të dalë duhet prezenca e të akuzuarit. Kjo sepse nga provat e nxjerra e në mënyrë decisive nga fletpagesa e bankës N. P. me seli në Prizren del se pagesat e lartpërmendur në emër të dëmtuarit përkatësisht firmës E. L. i ka bërë D. F. e cila edhe ka vërtetuar me faksimilen e saj të dhënë në fletpagesë se pagoi shumën e lartpërmendur në emër të firmës. Prandaj gjykata në prezencën e këtyre provave dhe rrethanave në mbështetje të nenit 364, paragrafi 1 pika 1.3 të KPP-së mori aktgjykim lirues duke u mbështetur edhe në parimin “in dubio pro reo”, mëdyshjet interpretohen në favor të të akuzuarit.

Andaj duke u bazuar në të lartë-theksuarat dhe provat të cilat u administruan në këtë çështje gjyqësore, gjykata nuk e ka provuar se i akuzuari B. Sh. e ka kryer veprën penale të keqpërdorimit të besimit nga neni 342 paragrafi 1 të KP të Kosovës dhe atë në harmoni me nenin 364 paragrafi 1 pika 1.3 të KPP-së, të njëjtin e ka liruar nga akti akuzues - vepra penale.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale është marrur në kuptim të nenit 454 të KPP-së.

Gjykata sa i përket kërkesës pasurore juridike, të dëmtuarin H. B. e udhëzoi në kontest të rregullt civil - juridik, në kuptim të nenit 463 të KPP-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në kuptim të nenit 364 paragrafi 1 pika 1.3 të KPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**

**P.nr.910/2013 datë 04.06.2015**

**Bashkëpunëtori profesional  
Atnor Skoro**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Artan Sejrani**

**UDHËZIM JURIDIK:** kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimet të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.